

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me zyrtarin ligjor Shaban Prekalla, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.F., nga Ferizaj, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.3 pika 3.2 lidhur me par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega Lipjan, P.nr.261/18, të dt.23.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 22.02.2019, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit H.F., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, P.nr.261/2018, të dt.23.11.2018, **vërtetohet**.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega Lipjan, P.nr.261/2018, të dt.23.11.2018, është shpallur fajtor i akuzuari H.F. , për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 pika 3.1 lidhur me par.1 të KPRK dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, cili do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, kurse me pëlqimin e të akuzuarit gjykata dënimin me burgim ia zëvendëson në dënimin me gjobë në shumë prej 1200 €, i cili dënim do të paguhet në 4 këste mujore, në të kundërtën gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënimin me burgim, konform nenit 46 par.3 të KPK, ku do të llogaritet shuma prej 20.00 €, për çdo ditë të kaluar në burgim.

I dëmtuari H. (A.) V. nga Prishtina, për realizmin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civilo - juridik.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor kësaj gjykate të ia paguajë shumën prej 20€ dhe për shpenzime të procedurës penale shumën prej 20€ si dhe shumën prej 30€ në Fondin e Mbrojtjes së Viktimave të Krimit, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë i akuzuari, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa e ushtruar të aprovohet si e bazuar dhe dënimi me burgim të kushtëzohet, ose lartësia e dënimin me gjobë të jetë më e ulët.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.43/2019, të datës 28.01.2019, duke u sqaruar përkritazi me ankesën e të akuzuarit, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

### **Ankesa e të akuzuarit H.F., nuk është e bazuar.**

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit për sanksionin penal, duke theksuar se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se është penduar për veprën e kryer penale, se ka premtuar që në të ardhmen nuk ka me ra në kundërshtim me ligjin, se ka qenë i provokuar në kohën e kryerjes së veprës penale derisa ka qenë në oborrin e Qendrës Korrektuese, prej se është i gjendjes ekonomike jo të mirë, se është i moshës së re, andaj ka propozuar që ti shqiptohet dënimi me kusht.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari është mbajtës i vetëm i familjes, se ka pasur sjellje të mira pas kryerjes së veprës penale, se e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se është penduar për veprën e kryer penale, se ka premtuar që në të ardhmen nuk ka me ra në kundërshtim me ligjin, ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese e sidomos ka pasur parasysh shkallën e intensitetit të veprës penale të kryer, ka vlerësuar edhe ankesën e të akuzuarit, nga e cila nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, andaj në prani të këtyre rrethanave kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1. nr.20/19 të datës 22.02.2019**

**Zyrtari ligjor**  
**Shaban Prekalla**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Biljana Rexhiq**